

# ZBATIMI I AGJENDËS SË GJELBËR PËR KOSOVËN NJË VIT PAS SAMITIT TË SOFJES

Raport i progresit

06/2022

Ky punim është mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe implementuar nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Energjisë në Kosovë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve. Ato nuk pretendojnë të reflektojnë mbi mendimet ose pikëpamjet e GIZ.

# Përmbajtja

Hyrje .....	3
Metodologjia e monitorimit.....	4
Deklarata e Samitit të Sofjes.....	5
Shtylla 1 – Klima, energjia dhe mobiliteti.....	6
1.1. Politikat e Klimës dhe Dekarbonizimit.....	7
1.2. Eficienca e energjisë dhe burimet e ripërtrishme të energjisë .....	10
1.5. Infrastruktura.....	12
Shtylla 2 – Ekonomia qarkore.....	13
2.1. Prodhimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i mbeturinave .....	14
Shtylla 3 – Ndalimi i ndotjes .....	15
3.1. Ratifikimi i Konventës për ndotje ndër-kufitare dhe bashkëpunimi rajonal.....	15
3.2. Ndotja e ajrit dhe menaxhimi i ujit dhe tokave .....	15
Shtylla IV dhe Shtylla V – Bujqësi dhe prodhim ushqimor i qëndrueshëm dhe Biodiversiteti.....	18
4.1 Përafrimi me legjislacionin evropian dhe standardet për bujqësinë sanitare dhe organike .	18
Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit Kosovë – BE dhe instrumentet financiare .....	20
Instrumentet financiare të BE-së për përkrahjen e agjendës së gjelbër.....	21
IPA III dhe prioritizimi i agjendës së gjelbër .....	21
Përfundime.....	23
Rekomandime.....	25

## Hyrje

Agjenda e Gjelbër është marrëveshje evropiane që synon zbatimin e një strategjie të re zhvillimore duke bërë ndryshimet e nevojshme strukturore, me qëllim të neutralizimit të ndryshimeve klimatike dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Kjo marrëveshje ambicioze ofron një plan veprimi konkret për të bërë kontinentin evropian neutral ndaj karbonit deri në vitin 2050. Palët e pajtuara për të zbatuar agjendën në fjalë duhet të bëjnë reforma politike dhe financiare për të rritur përdorimin efikas të burimeve të tyre në mënyrë që të përshpejtohet tranzicioni drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe të gjelbër. Për më tepër, marrëveshja përshkruan edhe ndërmarrjen e masave të nevojshme dhe të duhura për mbrojtjen e ekosistemit ku jetojmë dhe ruajtjen e biodiversitetit. Ulja e nivelit të ndotjes së ajrit, pakësimi i emetimeve të gazrave serrë, ulja e ndotjes së burimeve të ujit si dhe reduktimi i ndotjes akustike, është synim tjetër i rëndësishme i përfshirë në një ndër objektivat tjera të vendosura për t'u arrirë, nën kornizën e kësaj marrëveshje.

Ky plan veprimi ka vendosur në dispozicion edhe mjetet e financimit, si dhe ka siguruar përshkrimin e politikave të duhura për investimet e nevojshme. Përmbushja e kriterëve të vendosura në Agjendën e Gjelbër do të sillte Kosovën në një pozitë më të mirë se më parë dhe do të kontribuonte direkt edhe në përmbushjen e kriterëve të pikave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe asaj të Deklaratës së Sofjes. Rruga drejtë zbatimit të Agjendës së Gjelbër kërkon përkushtim të madh dhe trajtim me prioritet të lartë nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe akterëve relevantë.

Me nënshkrimin e Deklaratës së Samitit të Sofjes në fund të vitit 2020, vendet e Ballkanit perëndimor kanë marrë përsipër një mori reformash strukturore me qëllim të përafrimit të kornizës legislative dhe të politikave me atë të BE-së, dhe me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve. Qëllimi përfundimtar është ekonomizimi dhe nxjerra e përfitimeve sa më të mëdha socio-ekonomike nga agjenda e gjelbër e BE-së. Kështu, Agjenda e Gjelbër nuk do të shihet vetëm nën dritën e procesit të integritimit në BE, por edhe si një mënyrë për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik të rajonit përmes politikave transformuese dhe konektivitetit.

Mbështetja e shoqërisë civile në procesin e zbatimit të Agjendës së Gjelbër do të jetë jetike. Tashmë Këshilli për Bashkëpunim Rajonal ka ndërtuar një Plan të Veprimit për zbatimin e Agjendës së Gjelbër dhe një Forum rajonal i organizatave të shoqërisë civile është gjithashtu funksional për të mbështetur zbatimin e kësaj agjende. Në Kosovë, Instituti INDEP, përveç që është pjesë e këtij forumi rajonal, është duke punuar në ndërtimin e një mekanizmi të monitorimit të zbatimit të Agjendës.

Ky raport është hartuar me qëllim pikërisht të ndërtimit të këtij instrumenti të avokimit me qëllim që pas çdo viti që kalon nga nënshkrimi i Deklaratës së Samitit të Sofjes, ne të identifikojmë rekomandimet që kemi, pjesët ku ka pasur dhe ku mungon progresi etj. Kemi ndërtuar një model të vlerësimit të zbatimit të pikave të Deklaratës, ashtu që të gjitha i kemi trajtuar si indikator dhe u kemi vënë nota vlerësimi varësisht nga zbatimi i tyre. Rekomandimet e listuara në fund, do të jenë bazë që ne të vijojmë me procesin e avokimit në vitin në vijim.

## Metodologjia e monitorimit

Metodologjia për hartimin e këtij punimi është e përzier, kuantitative dhe kualitative. Në pjesën e të dhënave kuantitative, mbledhja e informatave është bërë me metodën e hulumtimit në tavolinë. Janë marrë për bazë raportet e Komisionit Evropian, dokumentet qeveritare dhe të dhënat e tjera zyrtare. Përmes analizës së brendshme të INDEP, për indikatorët e identifikuar në të pesë shtyllat e Agjendës së Gjellbër, janë dhënë vlerësime kuantitative të tipit të shkallës së Likertit nga 1 deri në pesë. Ky vlerësim i kuantifikuar i përgjigjet shkallës së vlerësimit nga “pa progres” në “e zbatuar” – një praktikë e Komisionit Evropian në raportet e progresit për Kosovën por edhe e Institutit INDEP në të kaluarën. Shkalla e plotë e vlerësimit në matricë është si në vijim:



Në fund, pas gjenerimit të matricës për secilën nga Shtyllat është bërë një analizë e brendshme ku kemi dhënë vlerësimet për secilën shtyllë dhe janë nxjerrë rekomandimet përkatëse. Duke qenë se raporti i progresit synon të jetë një publikim vjetor i Institutit INDEP, metodologjia e kalkulimit të vlerave dhe zbërthimit të mëtejme të tyre pritet të jetë një proces dinamik që do të pasurohet edhe në vitet e tjera. Me këtë ne kemi ndërtuar një model që do të jetë veçanërisht i dobishëm për vitet pasuese pasi viti i parë është si një pikë referimi për krahasim në të ardhmen.

Rekomandimet që kemi listuar në fund të raportit, reflektojnë nevojat për reforma gjatë vitit 2022 dhe deri në vitin e ardhshëm. Ato i kemi ndarë në bazë të shtyllave të Agjendës së Gjellbër me shtyllat 4 dhe 5 të fuzionuara. Rekomandimet e identifikuara do të shërbejnë për punë avokuese gjatë vitit në vazhdim dhe një analizë e zbatimit të tyre do të jetë pjesë e analizës së ardhshme të zbatimit të Agjendës.

## Deklarata e Samitit të Sofjes

Zotim për të punuar drejt zbatimit të suksesshëm të Marrëveshjes të Re të Gjellbër kanë dhënë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të Procesit të Berlinit, udhëheqësit e vendeve të këtij rajoni kanë nënshkruar me datë 10 nëntor, 2020 në Sofje të Bullgarisë Marrëveshjen Rajonale për Agjendën e Gjellbër ose ndryshe të ashtuquajturën Deklaratën e Samitit të Sofjes. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje obligon vendet e rajonit të përmbushin synimet e cekura në Agjendën e Gjellbër përmes një plani të veprimit që përfshin reforma politike dhe financiare me qëllime gjithëpërfshirëse, ashtu siç duhet t'i përmbushin të gjitha vendet që janë tanimë pjesë e BE-së. Kjo marrëveshje, ashtu si të gjitha marrëveshjet e nënshkruara paraprakisht që kanë bazë integrimin evropian kërkon mbështetje të plotë nga institucionet e vendeve të rajonit si dhe reformim të thellë e rreshtim krahas politikave relevante të BE-së në mënyrë që të përmbushen kriteret bazë të vendosura. Gjithsesi, përveç kriterëve bazë, në Deklaratën e këtij Samiti, u krijua një Agjendë me prioritet të përcaktuara, të cilat duhet përmbushur në mënyrë që qeveritë e vendeve që janë pjesë e kësaj marrëveshje të përmbushin obligimet e marra përsipër. Pikat e vendosura në këtë agjendë janë si në vijim:

*Të përforcobet mbështetja për sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë* – kjo shtyllë përfshin angazhimin e palëve nënshkruese në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe bërja e reformave të thella në sistemin e drejtësisë. Rritja e kapaciteteve për parandalimin e korrupsionit, monitorimi i vazhdueshëm i reformave, matja e rezultateve të këtyre reformave janë disa nga pikat kyçe të cekura nën ombrellën e kësaj shtylle.<sup>1</sup>

*Të përforcobet angazhimi në siguri dhe migracion* – të punohet drejtë parandalimit të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar kundër krimit ndërkombëtar dhe fenomeneve të tjera të jashtëligjshme. Poashtu krahas këtyre dy prioritetëve kjo shtyllë i jep edhe rëndësi të veçantë mbajtjes nën kontroll të armëmbajtjes ilegale.<sup>2</sup>

*Të mbështetet zhvillimi socio-ekonomik, duke u fokusuar veçanërisht në rini* – ky prioritet i radhës përfshin zgjerimin e shkallës së investimeve të huaja në vendet e rajoni, reformimin e sistemit arsimor dhe ofrimin e mundësive të shumta dhe adresimin e nevojave për të rinjtë duke krijuar politika të ndryshme inovative.<sup>3</sup>

*Të rritet lidhshmëria* – kjo shtyllë përfshin nisjen e projekteve të reja që përmirësojnë marrëdhëniet në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor si: Autostrada e Kaltër dhe Autostrada e Paqes (Nish - Prishtinë) të cilat mbështeten nga BE përmes përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor. Më tej të krijohet një strategji e re mbi sektorin e energjisë në Ballkan, si zgjerimi i Bashkimit Energjetik në këtë pjesë të Evropës, e cila do të mundësonte një stabilizim të energjisë dhe diversifikim të burimeve dhe furnizuesve, si dhe reforma në tregun e energjisë, Kjo mund të bëhet duke krijuar kështu një qëndrueshmëri për këtë sektor si dhe duke mundësuar promovimin dhe përdorimin e energjisë së ripërtëritshme. Integrimi në Tregun e Brendshëm të Energjisë

<sup>1</sup> Agjenda Prioritare e Sofjes; *Deklarata e Sofjes*; Eu Western Balkans Summit; 17 Maj, 2018, E qasshme në [https://www.consilium.europa.eu/media/34808/sofia-declaration\\_sq.pdf](https://www.consilium.europa.eu/media/34808/sofia-declaration_sq.pdf), Qasur më: 04.05.2021.

<sup>2</sup> Agjenda Prioritare e Sofjes; *Deklarata e Sofjes*; Eu Western Balkans Summit; 17 Maj, 2018, E qasshme në [https://www.consilium.europa.eu/media/34808/sofia-declaration\\_sq.pdf](https://www.consilium.europa.eu/media/34808/sofia-declaration_sq.pdf), Qasur më: 04.05.2021.

<sup>3</sup> Ibid.

Elektrike në BE është pikë tjetër e rëndësishme e kësaj agjende që bëhet vetëm duke punuar fillimisht për krijimin e një hapësire të vetme rregullative, pra për të përfunduar Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike në Ballkanin Perëndimor. Poashtu edhe krijimi i një strategjie të re hekurdhore për këtë rajon duke mundësuar pastaj kyçjen në rrjetin kryesor të BE-së.

*Një agjendë digjitale për Ballkanin Perëndimor* – të identifikohen investime të mundshme digjitale për vendet e Ballkanit Perëndimor përmes një pako ndihme nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor/Instrumenti i Ndihmës së Para Aderimit.<sup>4</sup>

*Të mbështetet pajtimi dhe marrëdhëniet fqinjësore të mira në Ballkanin Perëndimor* – të mbështeten Mekanizmat për ndëshkim për krimet në të kaluarën si Gjykatat Penale Ndërkombëtare dhe Dhomat e Specializuara për Kosovës dhe gjithashtu të mbështetet sektori i shoqërisë civile përmes Fondit për Ballkanin Perëndimor.<sup>5</sup>

## **Shtylla 1 – Klima, energjia dhe mobiliteti**

Shtylla e parë e Deklaratës së Samitit të Sofjes thekson në mënyrë specifike përkushtimin e vendeve të Ballkanit perëndimor për dekarbonizim të plotë deri në vitin 2050. Më specifikisht, liderët theksojnë që ata përkushtohen që: “të punojmë drejt objektivit të vitit 2050 për një kontinent neutral ndaj karbonit së bashku me BE-në përmes integritit të një politike strikte klimatike dhe reformimit të sektorëve të energjisë dhe transportit, dhe në veçanti përmes veprimeve të mëposhtme.”<sup>6</sup> Këto përkushtime, vendet e Ballkanit perëndimor do t’i realizonin duke përkthyer përkushtimet për veprime të marra në politika konkrete të sektorëve të ndryshëm në politikat e brendshme.

Ky përkushtim i vendeve të Ballkanit perëndimor e gjenë Kosovën në një deficit të politikave veçanërisht në fushën e klimës dhe energjisë. Këto dy elemente kyçe të shtyllës 1 të Deklaratës janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe sfiduese për t’u zbatuar plotësisht nga vendet e Ballkanit perëndimor.

---

<sup>4</sup> Agjenda Prioritare e Sofjes; *Deklarata e Sofjes*; Eu Western Balkans Summit; 17 Maj, 2018; E qasshme në [https://www.consilium.europa.eu/media/34808/sofia-declaration\\_sq.pdf](https://www.consilium.europa.eu/media/34808/sofia-declaration_sq.pdf); Qasur më: 04.05.2021.

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> RCC, (2020), Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans, e qasshme në <https://www.rcc.int/download/docs/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20WB.pdf/196c92cf0534f629d43c460079809b20.pdf> (qasur në prill, 2022)




Figura 1. Shtylla 1 e Deklaratës së Samitit të Sofjes dhe vlerësimi i zbatimit. Burimi: Matriksa e INDEP

Progresi shumë i limituar i identifikuar në Shtyllën e paërë, në masën më të madhe të tij është përbërë nga politika të cilat vetëm kanë qenë duke u zbatuar deri më tani. Në këtë kuptim, nuk ka progres real në periudhën e vitit të parë të zbatimit në fushën e parë të Deklaratës. Në vijim do të shohim të gjitha elementet e shtyllës së parë të zbërthyer dhe të vlerësuara sipas Matriksës së monitorimit të INDEP.

### 1.1. Politikat e Klimës dhe Dekarbonizimit

Në fushën e Klimës dhe Dekarbonizimit, Kosova nuk ka bërë pothuaj asnjë progres në vitin 2021. Sfidat kryesore mbesin:

- moszbatimi i Strategjisë së Klimës,
- mos miratimi i Ligjit për Ndryshime Klimatike,
- mungesa e një Strategjie të Dekarbonizimit dhe largimit nga qymyri,
- mungesa e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë

Zbatimi i politikave të klimës dhe dekarbonizimit do të ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm për Kosovën, në kohën kur ende mbi 90% e prodhimit të energjisë elektrike në vend është nga burimet ndotëse fosile dhe sektorët si transporti, industria e prodhimit dhe bujqësia janë pothuaj tërësisht të varur nga djegiet fosile. Në vitin 2021, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën kishte theksuar që: “Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Është arritur progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese, veçanërisht në raportimin mjedisor dhe monitorimin e cilësisë së ajrit.”<sup>7</sup> Në këtë kuptim, Raporti rekomandon:

Zbatimin e strategjisë së ndryshimeve klimatike dhe planin e veprimtimit për ndryshimet klimatike, përgatjen e një udhërrëfyes për përafrimin me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe

<sup>7</sup> Komisioni Evropian, (2021), Raporti për Kosovë, faqe 100, i qasshëm në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en) (qasur në prill, 2022)



acquis klimatike, miratimi i një Plan Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë dhe fillimin e hartimit të strategjisë afatgjate të dekarbonizimit.<sup>8</sup> Këto kërkesa të raportit të Komisionit Evropian nuk kanë gjetur zbatimin e duhur deri më tani.

Baza ligjore kryesore që ekziston në vend përbëhet nga:

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike (SPVNK) për periudhën 2019-2028/ 2019-2021
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.16/2013 për Substancat që Dëmtojnë Shtresën e Ozonit dhe Gazrat Serrë të Fluoruar;
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.19/2013 për Qasje në Informata për Shpenzimin Ekonomik të Karburanteve dhe Emisionin e CO2 të Automjeteve të Reja Personale;
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.20/2013 për Zbatimin e Mekanizmave Fleksibil për Zhvillim të Pastër, -
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.01/2016 për Mekanizmin e Përcjelljes së Emisioneve të Gazrave Serrë;
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.09/2015 për Përcjelljen e Emisioneve të Gazrave Serrë
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.14/2018 për Depozitim të Dioksidit të Karbonit në Formacionet e Përshtatshme Gjeologjike.

Nga progresi që është vërejtur dhe veçanërisht në indikatorët 1 dhe 7 të shtyllës 1 të Deklaratës, është hartimi dhe miratimi i Koncept Dokumentit për ndryshimet Klimatike. Ky koncept dokument është hartuar dhe miratuar por ende nuk kemi një draft të Ligjit për Ndryshime Klimatike. Koncept dokumenti ka theksuar problemet kryesore në fushën e ndryshimeve klimatike duke theksuar se “Menaxhimi jo i mirë i çështjes së ndryshimeve klimatike, mungesa e mbrojtjes së mjedisit në të kaluarën, veçanërisht në fushën e emisioneve të gazrave serrë nga sektorët e ndryshëm si industria, komunikacioni, bujqësia, pylltaria, etj. të cilat sot paraqesin burim të problemeve të mëdha mjedisore.”<sup>9</sup>

<b>1.1. Politikat e Klimës dhe Dekarbonizimit</b>		Statusi	Nota
1	Përafrimi me legjin e BE-së mbi Klimën sapo të miratohet - me një vizion të qartë për neutralitet ndaj klimës deri në vitin 2050	Ka progres	3
2	Vendosja e objektivave largpamëse për energjinë dhe klimën për vitin 2030 në përputhje me kornizën e Komunitetit të Energjisë dhe acquis të BE-së, si dhe zhvillimi dhe zbatimi i planeve të integruara për Energjinë dhe Klimën me masa të qarta të dizajnuara për të reduktuar emetimet e gazeve serrë në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duke integruar veprimet klimatike në të gjitha politikat përkatëse sektoriale	Progresi i limituar	2
3	Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të përshtatjes klimatike për të rritur qëndrueshmërinë përmes mbrojtjes ndaj klimës së investimeve dhe për të siguruar integrim më të madh të	Pa progres	1

<sup>8</sup> Komisioni Evropian, (2021), Raporti për Kosovë, faqe 100, i qasshëm në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en) (qasur në prill, 2022)

<sup>9</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, (2019), Koncept Dokumenti për Ndryshime Klimatike, i qasshëm në <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/40768-UpdAl.pdf> (qasur në prill, 2022)

	përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike me reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.		
4	Vazhdimi i harmonizimit me Skemën e Tregtimit të Emetimeve të BE-së, si dhe puna drejt futjes së instrumenteve të tjera të çmimit të karbonit për të promovuar dekarbonizimin në rajon.	Pa progres	1
5	Rritja e mundësive për vendosjen e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të zbutur dhe përshtatur ndryshimet klimatike.	Pa progres	1
6	Në funksion të nisjes së Paktit Evropian për Klimën, shqyrtoni zhvillimin e një mekanizmi të ngjashëm në rajon ose mundësitë që rajoni të marrë pjesë në këtë nismë.	Progres i limituar	2
7	Rishikimi dhe rishikimi, aty ku është e nevojshme, të gjithë legjislacionin përkatës për të mbështetur dekarbonizimin progresiv të sektorit të energjisë dhe për të siguruar zbatimin e plotë, veçanërisht nëpërmjet Komunitetit të Energjisë;	Ka progres	3
8	Të bashkëpunojnë në përgatitjen e një vlerësimi të ndikimit socio-ekonomik të dekarbonizimit në nivel ekonomie individuale dhe rajonale me synimin për një tranzicion të drejtë;	Pa progres	1
21	Zhvilloni dhe zbatoni plane për përshtatshmërinë ndaj klimës për rrjetet e transportit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor dhe promovoni përgatitjen dhe zbatimin e Planeve të Qëndrueshme të Lëvizjes Urbane për zonat urbane në Ballkanin Perëndimor.	Progres i limituar	2

Klima dhe dekarbonizimi janë ndër treguesit kryesor të shtyllës së parë të Deklaratës së Samitit të Sofjes. Miratimi i Ligjit për Ndryshime klimatike do t'i hapë rruga zbatimit dhe transpozimit të Rregullores Nr. 2018/1999/BE për Menaxhimin me unionin energjetik dhe veprimin në fushën e ndryshimeve klimatike, obligim që del nga MSA dhe Traktati i Komunitetit për Energji.<sup>10</sup> Gjithashtu, Rregullorja, sikur edhe ndryshimet klimatike, thekson nevojën për të:

- zbatuar strategjitë dhe masat e hartuara për të përmbushur objektivat dhe caqet e Unionit të Energjisë dhe angazhimet afatgjata të emetimeve të gazrave serrë të Bashkimit në përputhje me Marrëveshjen e Parisit dhe për periudhën e parë dhjetëvjeçare, nga viti 2021 deri 2030, në veçanti caqet për vitin 2030 lidhur me energjinë dhe klimën;
- stimuluar bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare, duke përfshirë aty ku është e mundur, në nivel rajonal, të paraparë për të arritur objektivat dhe caqet e Unionit të Energjisë;
- siguruar afatin kohor, transparencën, saktësinë, qëndrueshmërinë, krahasueshmërinë dhe plotësinë e raportimit tek sekretariati i UNFCCC-së dhe i Marrëveshjes së Parisit;

<sup>10</sup> Bashkimi Evropian, (2018), Regulation (EU) 2018/1999 Of The European Parliament And Of The Council of 11 December 2018 on the Governance of the Energy Union and Climate Action, amending Regulations (EC) No 663/2009 and (EC) No 715/2009 of the European Parliament and of the Council, Directives 94/22/EC, 98/70/EC, 2009/31/EC, 2009/73/EC, 2010/31/EU, 2012/27/EU and 2013/30/EU of the European Parliament and of the Council, Council Directives 2009/119/EC and (EU) 2015/652 and repealing Regulation (EU) No 525/2013 of the European Parliament and of the Council, e qashme në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32018R1999> (qasur në prill, 2022).

- kontribuar për siguri më të madhe rregullatore si dhe në siguri më të madhe të investitorëve dhe për të ndihmuar në shfrytëzimin e plotë të mundësive për zhvillim ekonomik, nxitje të investimeve, krijim të vendeve të punës dhe kohezion social.<sup>11</sup>

Politikat e ndryshimeve klimatike do të jenë në qendër të vendimmarrjes në Bashkimin Evropian por edhe në Kosovë përmes Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Një ndër sfidat në Kosovë mbetet kuadri institucional që ende nuk trajton çështjet e ndryshimeve klimatike si tema ndër-sektoriale ku bashkëpunimi i të gjithëve do të, ishte i domosdoshëm. Një pikë-takimi në mes të politikave të klimës dhe mjedisit pa dyshim mbetet energjia, vëmendja për të cilën duket se nuk ka alternativeë në muajt dhe vitet në vijim.

## 1.2. Eficienca e energjisë dhe burimet e ripërtrishme të energjisë

Progresi në fushën e eficiencës së energjisë dhe në burimet e ripërtrishme të energjisë ka qenë kryesisht i limituar përgjatë gjithë tabelës së indikatorëve. Zbatimi i bazës ligjore në fushën e eficiencës dhe burimeve të ripërtrishme mbetet ndër sfidat kryesore. Krahas kësaj, mungesa e bazës së mjaftueshme ligjore veçanërisht në fushën e burimeve të ripërtrishme të energjisë është gjithashtu evidente.

Në fushën e eficiencës së energjisë, Fondi i Eficiencës së Energjisë ka kryer përgatitjen e mbi 70 projekteve të cilat priten të zbatohen në bashkëpunim me komunat e Kosovës. Në anën tjetër, Ligji Nr. 05/L-101 për Performancën Enegetike në Ndërtesa nuk ka gjetur ende zbatimin e duhur veçanërisht sa i takon certifikimit të ndërtesave dhe regjistrimit të ndërtesave, etiketimit të ndërtesave dhe auditimit në shkallë të gjerë të tyre.

Aktiviteti Ekonomik	2018 ëktoeç	2019 ëktoeç	2020 ëktoeç
Spektori i industrisë	272,47	319.81	319.92
Spektori i amvisërisë	573,40	575.38	628.09
Spektori i shërbimeve	137,73	151.73	146.06
Spektori i bujqësisë	31,21	38.02	36.32
Spektori i transportit	426,71	422.58	412.46
<b>Total</b>	<b>1441,5 ktoe</b>	<b>1507.5 ktoe</b>	<b>1542.85 ktoe<sup>12</sup></b>

Niveli i konsumit të energjisë për sektorët kryesor zhvillimor në vend vazhdon të jetë në rritje. Megjithatë, trendi i rritjes është kryesisht tek sektori i amvisërisë, konsumi i të cilit i shprehur në ktoe ka shënuar rritje prej 9.5% nga viti 2018 deri në vitin 2020.

1.2. Eficienca e energjisë dhe burimet e ripërtrishme			
9	Jepini prioritet eficiencës së energjisë dhe përmirësoni atë në të gjithë sektorët	Progres i limituar	2

<sup>11</sup> Ibid.

<sup>12</sup> Niveli i konsumit të energjisë sipas sektorëve përgjatë viteve 2018-2020. Burimi: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

10	Mbështetja e skemave të rinovimit të ndërtesave private dhe publike, sigurimi i financimit të duhur dhe zbatimi i plotë i Direktivës së Performancës Energjetike të Ndërtesave (përshtatur sipas kornizës së Komunitetit të Energjisë)	Pa progres	1
11	Rritja e pjesës së burimeve të ripërtrishme të energjisë dhe sigurimi i kushteve të nevojshme investimi, në përputhje me acquis dhe objektivin e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë.	Progres i rëndësishëm	4
12	Përpquni eriozisht të ulni dhe t'i heqni gradualisht subvencionet e qymyrit, duke respektuar rreptësisht rregullat e ndihmës shtetërore	Pa progres	1
13	Pjesëmarrja në nismën e Rajonit të Qymyrit në Tranzicion për Ballkanin Perëndimor.	Progres i rëndësishëm	4
14	Zhvillimi i programeve për trajtimin e varfërisë energjetike dhe skemat e financimit për rinovimin e shtëpive të familjeve dhe sigurimin e standardeve bazë të jetesës.	Pa progres	1
7 Shtylla IV	Mbështetja e investimeve në prodhimin dhe teknologjitë e energjisë së rinovueshme, si dhe reduktimin e emetimeve dhe përshtatjen ndaj masave të ndryshimeve klimatike në bujqësi.	Pa progres	1

Në fushën e burimeve të ripërtrishme të energjisë, problemet kryesore të identifikuara mbesin mungesa e Ligjit për Burimet e Ripërtrishme, Skema e pafavorshme e mbështetjes për BRE-të

- Direktiva mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/944
- Rregulloren për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/943
- Rregulloren mbi gatishmërinë ndaj rrezikut në sektorin e energjisë elektrike BE 2019/941
- Rregulloren mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimin ndaj Klimës (BE)
- Direktiva e Performancës së Energjisë së Ndërtesave (BE) 2018/844;
- Direktiva e Energjisë së Ripërtërtrishme (BE) 2018/2001;
- Direktiva për Eficiencën e Energjisë (BE) 2018/2002, dhe
- Rregulloren mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (BE) 2019/942.<sup>13</sup>

<sup>13</sup> Komisioni Evropian, Paketa e energjisë për të gjithë evropianët, 3 maj 2021, në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/clean-energy-all-europeans\\_en#governance-regulation](https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/clean-energy-all-europeans_en#governance-regulation).

## 1.5. Infrastruktura




Figura 2. Harta e Rrugëve të Kosovës. Burimi: Ministria e Infrastrukturës

Në pjesën e infrastrukturës, nuk është shënuar ndonjë progres i theksuar gjatë vitit të parë që nga miratimi i Agjendës së Gjellbër. Ndonëse Kosova ka një infrastrukturë tashmë të vendosur rrugore në vend siç shihet në figurën në vazhdim, mirëmbajtja e infrastrukturës, digjitalizimi dhe bashkëpunimi rajonal mbesin ndër sfidat kryesore me të cilat përballet fusha e Infrastrukturës.<sup>14</sup>

Zhvillimi i infrastrukturës në përgjithësi ka qenë i njëanshëm në favor të infrastrukturës rrugore duke lënë anash infrastrukturën hekurudhore, digjitalizimin dhe bashkëpunimin rajonal. Tabela vlerësuese në vazhdim tregon se si në pjesën më të madhe të indikatorëve, progresi ka qenë i limituar ose nuk ka pasur progres fare.

1.5. Infrastruktura			
15	Mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës inteligjente, promovimi i nxitjes së teknologjive inovative dhe forcimi i bashkëpunimit ndërrajonal, siç tregohet nga nisma e Korsive të Gjellbërta/Korridoreve;	Progres i limituar	2
16	Zbatoni planin rajonal të veprimit për reformat hekurudhore të miratuar nga partnerët rajonalë në 2020.	Progres i limituar	2
17	Përcaktoni korridoret hekurudhore të mallrave dhe transportin e rrugëve ujore të brendshme dhe një strategji të përgjithshme për të zhvendosur trafikun nga rrugor në mënyra më miqësore me mjedisin;	Pa progres	1
18	Të sigurojë zbatimin e standardeve teknike të BE-së dhe dixhitalizimin e të gjitha mënyrave të transportit;	Pa progres	1
19	Të mbështesë në mënyrë aktive zbatimin e planit rajonal të veprimit për lehtësimin e transportit, duke përfshirë pikat e kalimit që lidhin ekonominë e Ballkanit Perëndimor, duke synuar operacione transporti me burime efikase që do të kontribuojnë në reduktimin e emetimeve të CO <sub>2</sub> ;	Progres i limituar	2
20	Zbatimi i planit të veprimit për sigurinë rrugore, si dhe plani i veprimit rrugor duke përfshirë mirëmbajtjen e rrugëve dhe përshtatshmërinë dhe sistemet inteligjente të transportit;	Pa progres	1
22	Përcaktoni dhe zbatoni zgjidhje të qëndrueshme mobiliteti në nivel rajonal, duke përfshirë planet për vendosjen e karburanteve alternative dhe ndërtimin e stacioneve të rimbushjes dhe	Pa progres	1

<sup>14</sup> Komisioni Evropian, (2021), Raporti për Kosovë, faqe 100, i qasshëm në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en) (qasur në prill, 2022)






Figura 3. Numri i vdekjeve me fatalitet në Kosovë dhe rajon 2010-2020. Burimi: Ministria e Infrastruktues

Ndënësë siç tregon figura e mësipërme, Kosova ka shënuar progres në fushën e zvogëlimit të aksidenteve me fatalitet dhe qëndron në mesin e vendeve me më pak aksidente të tilla, niveli i zbatimit të Agjendës së Gjellbër dhe veçanërisht indikatorit Nr.18 që “të sigurojë zbatimin e standardeve teknike të B E-së dhe dixhitalizimin e të gjitha mënyrave të transportit”. Nevojitet gjithashtu jetësimi I projekteve rajonale të infrastrukturës hekurudhore, projekteve të menaxhimit ndër-kufitar etj.

## Shtylla 2 – Ekonomia qarkore

Sa i takon shtyllës së dytë të ekonomisë qarkore, nuk ka ndonjë progres të theksuar. Kosova ende nuk ka rregulluar me kërkesa teknike proceset e prodhimit të qëndrueshëm. Megjithëse Agjencia e Standardizimit i ka shndërruar në standarde kosovare një pjesë të konsiderueshme të standardeve CEN dhe CENELEC, nuk ka kritere teknike me rregullore për përcaktimin e proceseve të brendshme të prodhimit.

Shtylla 2 – Ekonomia qarkore



### 2.1. Prodhimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i mbeturinave

Ka progres shumë të limituar në prodhimin e qëndrueshëm të brendshëm dhe në menaxhimin e mbeturinave. Shumica e problemeve janë trashëguar nga viti në vit. Kosova ka të miratuar Ligjin për Kërkesa Teknike për Vlerësim të Konformitetit me të cilin rregullohet mënyra e përcaktimit të kërkesave teknike për produkte dhe miratimi i rregulloreve teknike, vlerësimi i konformitetit të produkteve me kërkesat e përcaktuara teknike (në tekstin e mëtejme: vlerësimi i konformitetit), detyrimet e operatorëve ekonomik të produkteve dhe pronarëve të produkteve në përdorim, vlefshmëria e dokumenteve të huaja të konformitetit dhe shenjave të konformitetit, notifikimi i rregulloreve teknike dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit, si dhe mbikëqyrja inspektuese në zbatimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve teknike që kanë të bëjnë me përputhshmërinë dhe sigurinë e produkteve jo-ushqimore.

2.1. Prodhimi i qëndrueshëm		Statusi	Nota
1	Integrimi i Ballkanit Perëndimor në zinxhirët e furnizimit industrial të BE-së duke: o Ndërmarrja e veprimeve vendimtare për përmirësimin e qëndrueshmërisë së prodhimit primar të lëndëve të para; o Zbatimi i një qasjeje të ekosistemit industrial për të arritur një përmirësim të qëndrueshëm mjedisor dhe të balancuar ekonomik në të gjithë rajonin, veçanërisht për ekosistemet kryesore industriale të qëndrueshme si energjia e rinovueshme, dixhitale, lëvizshmëria; dhe sektorë industrialë me burime intensive si turizmi, tekstili, transporti-automobilat dhe industritë me intensitet energjie;	Progres i limituar	2
2	Zhvilloni strategji të ekonomisë qarkore duke parë të gjithë ciklin jetësor të produkteve, parandalimin e mbetjeve, menaxhimin dhe riciklimin modern të mbetjeve, ripërdorimin, riparimin dhe riprodhimin	Progres i limituar	2
3	Të bëhet progres të mëtejshëm në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve për qytete dhe rajone;	Ka progres	3



4	Hartimi dhe zbatimi i iniciativave të orientuara nga konsumatori për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mbetjet, grumbullimin e veçantë dhe konsumin e qëndrueshëm;	Pa progres	1
5	Përfundimi dhe zbatimi i një marrëveshjeje rajonale për parandalimin e ndotjes plastike, duke përfshirë adresimin në mënyrë specifike të çështjes prioritare të mbeturinave detare;	Pa progres	1
6	Zbatoni më tej Strategjitë e Specializimit të menqur, axhenda të transformimit të orientuara kah lokalitetet dhe të udhëhequra nga inovacioni për qëndrueshmëri.	Pa progres	1

### Shtylla 3 – Ndalimi i ndotjes

Në pjesën e ndalimit të ndotjes, Kosova si dhe vendet e tjera ende nuk kanë ndërtuar mekanizma të bashkëpunimit rajonal siç e kërkon Agjenda e Gjellbër. Ndotja, dhe veçanërisht ndotja industriale mbetet një ndër prioritetet që kërkon futje në agjendën e politikave. Probleme të tjera të ndotjes përfshijnë edhe mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, mos pastrimi i mbetjeve radioaktive, kontaminimi i ujërave nëntokësor etj.

#### 3.1. Ratifikimi i Konventës për ndotje ndër-kufitare dhe bashkëpunimi rajonal

Objektivi 1 dhe objektivi 8

<b>3.1. Ratifikimi i Konventës për ndotje ndër-kufitare dhe bashkëpunimi rajonal</b>		Statusi	Nota
1	Finalizimi i procesit të ratifikimit të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me rreze të gjatë dhe protokolleve të saj (duke përfshirë ndryshimet) në secilën nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor	Pa progres	1
8	Përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjeve rajonale për ndotjen ndërkufitare të ajrit dhe ujit.	Pa progres	1

#### 3.2. Ndotja e ajrit dhe menaxhimi i ujit dhe tokave

Ndotja e ajrit mbetet ndër sfidat kryesore me të cilat përballet Kosova. Në bazë të kalkulimeve nga platforma e kontrollit dhe përcjelljes së cilësisë së ajrit, në rreth 30% të ditëve të vitit cilja e ajrit është e keqe, shumë e keqe apo tmerrësisht e keqe. Figura në vazhdim paraqet mesataret e kualitetit të ajrit në 365 ditë të vitit.



### Kualiteti i ajrit në 365 ditet e fundit në Kosovë




Figura 4. Kualiteti i ajrit në 365 ditët e fundit në Kosovë. Burimi: Agjencioni Hidrometeorologjik i Kosovës<sup>15</sup>

3.2. Ndotja e ajrit dhe menaxhimi i ujit dhe tokave			
2	Zhvillimi dhe zbatimi i Strategjive të Cilësisë së Ajrit dhe rritja e përdorimit të teknikave më të mira të disponueshme në përputhje me Direktivën e Emetimeve Industriale;	Ka progres	3
3	Krijimi i sistemit adekuat të monitorimit të cilësisë së ajrit, duke përfshirë akreditimin e rrjeteve të monitorimit të cilësisë së ajrit;	Progres i rëndësishëm	4
4	Zbatimi i acquis-së përkatëse të BE-së lidhur me ujin (Direktiva Kuadër e BE-së për Ujërat, Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Mbeturinave Urbane dhe Direktiva për Nitratet);	Progres I limituar	2
5	Modernizimi i infrastrukturës së monitorimit të ujit dhe arritja e statusit të mirë për të gjithë trupat ujorë;	Progres I limituar	2
6	Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për trajtimin e ujërave të zeza	Ka progres	3

Progresi në realizimin e Agjendës së Gjellbër në fushat e mjedisit është i paktë. Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013-2022 duhet të ripërtrihet me përfshirje të të gjithë akterëve dhe me një qasje gjithë akterëve. Rritja e bashkëpunimit rajonal duhet të jetë po ashtu një prioritet si dhe nisja e përgatitjeve për Kapitullin 27 të procesit të integritimit evropian. Në këtë kuptim, shoqëria civile tashmë ka bërë disa hapa përhapura me krijimin e Kualicionit 27 gjatë vitit 2021 i cili ka për qëllim monitorimin e politikave në fushën e mjedisit dhe klimës dhe raportimin vjetor për progresin e Kosovës në realizimin e objektivave të Kapitullit 27 të integritimit.

<sup>15</sup> Për më shumë: <https://ihmk-rks.net/?page=1,5>



*Figura 5. Themelimi i Koalicionit 27 në Kosovë*

## **Shtylla IV dhe Shtylla V – Bujqësi dhe prodhim ushqimor i qëndrueshëm dhe Biodiversiteti**

### **4.1 Përafrimi me legjislacionin evropian dhe standardet për bujqësinë sanitare dhe organike**

Në pjesën e obiversitetit Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 52 Përgjegjësia për Mjedisin, përcakton "Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi e të gjithëve" në këtë drejtim Ligji themelor për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03 / L-233 GZK Nr. 85 me Nenin 1 përcakton se "natyra përfaqëson të gjithë diversitetin biologjik dhe peizazhor" kurse Neni 4 përcakton "natyra dhe vlerat e trashëgimisë natyrore janë me interes për Republikën e Kosovës dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë".

Legjislacioni bazë për mbrojtjen e natyrës në Republikën e Kosovës:

1. Ligji Nr. 03 / L-233, për Mbrojtjen e Natyrës
2. Ligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" Nr. 04 / L-086;
3. Ligji për Parkun Kombëtar "Sharri" Nr. 04 / L-087;
4. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03 / L- 025;
5. Ligji për Pyjet e Kosovës Nr. 2003/3;
6. Ligji për Gjuetinë Nr. 02 / L-53;
7. Ligji për Ujërat Nr. 04 / L-147;
8. Ligji për Minierat dhe Minalet Nr. 03 / L-163;
9. Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04 / L-174;
10. Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr. 03 / L-230;
11. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03 / L-214;
12. Ligji për Mbeturinat Nr. 04 / L-060;
13. Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 2011/04 - L-082; dhe
14. Legjislacioni sekondar për zbatimin e këtyre ligjeve.

Bujqësia është ndër fushat në të cilat ka pasur më së shumti investime publike në dhjetë vitet e fundit. Pjesëmarrja në bruto-produktin vendor në bujqësi në dhjetë vitet e kaluara ka mbetur kryesisht e njëjtë ndonëse niveli i subvencioneve është rritur në mënyrë të vazhdueshme.




Figura 6. Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor 2010-2020, (në %). Burimi: Raporti i Gjellbër i Ministrisë së Bujqësisë

Në vitin 2020, shuma totale e pagesave direkte për kultura bujqësore duke përfshirë verën dhe sigurimin bujqësor ishte 41.3 mil. €. Pjesëmarrje më të madhe në totalin e pagesa direkte për kultura bujqësore kishin gruri (34%), misri (21%), vreshtat (15%), perimet (13%), pemishtet (9%) ndërsa kulturat e tjera kishin pjesëmarrje prej 8% në totalin e pagesave direkte për kultura bujqësore. Në përgjithësi shikuar njësitë e subvencionuara, të gjithë kulturat dhe sektorët e mbështetur kanë shënuar rritje përveç sipërfaqes me elb dhe luledielli që kanë shënuar ulje si dhe numri i litrave të verës së subvencionuar.<sup>16</sup>

Gjatë vitit të ardhshëm më shumë përpjekje duhet për digjitalizimin e proceseve në bujqësi, vlerësimin dhe përcjelljen e subvencioneve dhe për lehtësimin e tranzicionit. Paket e rimëkëmbjes gjithashtu mund të shoqërohen me kërkesa që kanë të bëjnë me rindërtimin më të mirë dhe transformimin e bujqësisë.

<sup>16</sup> Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, (2022), Raporti i Gjellbër 2021, i qasshëm në [https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Raporti\\_i\\_Gjellber\\_2021\\_.pdf](https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjellber_2021_.pdf) (qasur në maj, 2022)

## **Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit Kosovë – BE dhe instrumentet financiare**

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është marrëveshje kontraktuale mes BE-së dhe vendeve që duan ti bashkohen këtij entiteti. Kosova ka nënshkruar këtë marrëveshje me BE-në më 27 tetor 2015, në Strasburg<sup>17</sup>. Agjenda e një marrëveshjeje të tillë ndërkombëtare është gjithësesi mjaft gjithëpërfshirëse dhe përcakton reforma të thella në të sferat e qeverisjes si dhe definojnë mekanizma dhe afate për realizimin e këtyre reformave. Përbushja e këtyre obligimeve e për afron Kosovën me standardet e BE-së, duke ndikuar kështu në çdo aspekt të jetës së një qytetari në Kosovë. Edhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit përmban komponenta të rëndësishme për të shtyrë përpara Agjendën e Gjellbër në Kosovë. Neutralizimi i ndryshimeve klimatike, ekonomia e qëndrueshme, energjia, mbrojtja e mjedisit janë disa nga objektivat e paraqitura në të dy marrëveshjet. Për arritjen e këtyre objektivave sipas afateve të caktuara dhe mekanizmave të duhur, institucionet tona duhet të punojnë paralelisht dhe në mënyrë të koordinuar.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parasheh avancim dhe plotësim të kriterëve të caktuara në fushën e energjisë, për të shtyer përpara Agjendën e Gjellbër, ashtu që rrjedhimisht Kosova me hapa të sigurte të përgatitet për integrim evropian.

Neutralizimi i ndryshimeve klimatike sipas nenit 116 në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit përfshijnë ndryshimin e nevojshëm të politikave në sektorët e energjisë, transportit, industrisë, bujqësisë etj. Gjithësesi që zbatimi i këtij kriteri duhet të fillojë me harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së. Ngritja e kapaciteteve administrative dhe koordinimi ndër-institucional është i nevojshëm në mënyrë që të miratohen dhe zbatohen politika që mundësojnë uljen e karbonit dhe përfshijnë Kosovën në përpjekje globale për neutralizimin e ndryshimeve klimatike.<sup>18</sup> Sipas Raportit të Progresit për vitin 2020, Kosova ngelet prapa në zbatimin e strategjisë për ndryshime klimatike. Duke qenë se mbështet shumë në burime konvencionale, është mjaft e pasur me lëndë djegëse si fosile dhe minerale tjera, për Kosovën mbetet sfida përdorimi dhe investimi i burimeve të ripërtërishme si dhe zbatimi i strategjisë për ndryshime klimatike. Kosova nuk është palë nënshkruese e Konventës për Ndryshime Klimatike, prandaj nuk ka obligime kombëtare për përbushjen e kriterëve që prodhon kjo Konventë, megjithatë duke ju përmbytur këtyre kriterëve, Kosova përbush obligimet e saj që i përcaktohen me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit si dhe me Deklaratën e Sofjes.

Sipas kriterëve të vendosura në Marrëveshje, Kosova duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me atë evropian edhe në sektorin e energjisë. Për më tepër, Kosova duhet të integrohet gradualisht në tregjet evropiane të energjisë, duhet të përmirësojë dhe të shumëfishojë furnizimin dhe qasjen në tregun e energjisë, duhet të rris eficiencën e energjisë dhe të krijojë mekanizma apo instrumente për të rritur përdorimin e burimeve të ripërtërishme.<sup>19</sup> Megjithatë, edhe pse Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ka tashmë gjashtë vite që është nënshkruar, fusha e energjisë ka pasur progres, por në nivel të ulët. Raporti i Progresit 2020 tregon se Kosova ka një nivel të përgatitjes në fushën e energjisë, edhe pse jo të mjaftueshëm<sup>20</sup>. Sipas këtij raporti, Kosovës ende i duhet harmonizim i

<sup>17</sup> Ministria e Integritimit Evropian MSA; E qasshme në <http://www.mei-ks.net/sq/historiku>; Qasur më 04.05.2021.

<sup>18</sup> Neni 116; Ndryshimet Klimatike; *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit*; E qasshme në [https://www.mei-ks.net/repository/docs/20170425093025\\_msa\\_shq.pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/20170425093025_msa_shq.pdf); Qasur për herë të fundit më: 04.05.2021.

<sup>19</sup> Neni 114; *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit*; E qasshme në [https://www.mei-ks.net/repository/docs/20170425093025\\_msa\\_shq.pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/20170425093025_msa_shq.pdf); Qasur për herë të fundit më: 04.05.2021.

<sup>20</sup> *Raporti i Progresit 2020 për Kosovën*; Bruksel: Komisioni Evropian; 6.10.2020; faqe 96; E qasshme në <https://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>.

plotë me legjislacionin evropian dhe rritje të investimeve të energjisë së ripërtërishme. Rekomandimet kryesore në raport, sa i përket fushës së energjisë janë: avancimet mjedisore të Termocentralit Kosova B dhe largimin nga përdorimi të Termocentralit Kosova A. Raporti gjithashtu rekomandon funksionalizimin e Fondit të Eficiencës së Energjisë dhe stimulimin e përdorimit të energjisë eficiente në sektor publik dhe sektor privat. Ndërsa, rekomandimi i fundit është përditësimi i strategjisë në Kosovë me fokus në energjinë e ripërtërishme, eficiencën e energjisë dhe dekarbonizimin.

Disa nga mundësitë për të implementuar rekomandimet e raportit të progresit, është edhe vendosja e skemave mbështetëse dhe masave stimuluese të gjelbra për të rritur përdorimin e energjisë në sektorin publik dhe privat. Gjithsesi që amandamentimi dhe ndryshimi i Ligjit për Energji është hap i domosdoshëm për progres në këtë sektor. Poashtu edhe krijimi i strategjive të reja, priorizimi i këtij sektori në agjendat qeveritare si dhe monitorimi i masave të ndërmarra mundësojnë që kriteret e vendosura për jetësimin e Agjendës së Gjelbër në Kosovë të fillojnë të përmbushen me hapa të sigurtë.

Sa i përket fushës së mjedisit, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ka të vendosur si kriter kryesor ndalimin e degradimit të vazhdueshëm mjedisor. Edhe në këtë fushë harmonizimi dhe përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë evropian mbetet pikë e rëndësishme në të cilën ka nevojë urgjente për të intervenuar. Cilësia e ajrit dhe ujit, mbrojtja e natyrës, zvogëlimi i emetimeve industriale janë ndër kriteret kryesora të vendosura për t'u plotësuar me qëllim të integrim të Kosovës në Bashkim Evropian. Zhvillimi i strategjive konkrete për zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe burimeve ujore jo vetëm në nivel lokal por atë rajonal dhe ndërkufitar si dhe realizimi i vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe atij strategjik mjedisor mbeten në vazhdimësi kriteret e domosdoshme për tu plotësuar.<sup>21</sup> Për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike, biodiversiteti e ruajtja e mjedisit është i domosdoshëm themelimi i strukturave efikase për analizimin dhe realizimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe vlerësimi strategjik mjedisor. Nëse për çdo projekt qoftë publik apo privat, integrimet e praktikave të nevojshme si VMN dhe VSM bëhen të domosdoshme atëherë kjo do të kontribuonte në ruajtjen e mjedisit dhe rrjedhimisht përmirësimin e cilësisë së jetës së njeriut në Kosovë.

Në Raportin e Progresit të vitit 2020 Kosova ndër të tjerash rekomandohet të marrë masa urgjente për zvogëlimin e ndotjes së ujit dhe ajrit, të krijojë sistem të monitorimit të ujërave, dhe të publikojë të dhëna të vazhdueshme mbi gjendjen e ujit dhe ajrit në Kosovë. Edhe në këtë sektor mbetet problem jo-harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian dhe krijimi i një strategjie të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit. Pra për ta përmbledhur, sipas këtij raporti Kosova në vitin 2020, mbetet në fazën e hershme të progresit në këtë sektor. Ka pasur progres të vogël në monitorimin e ajrit dhe raportimin mjedisor, por në pikat tjera nuk ka për të mos thënë fare progres.

### **Instrumentet financiare të BE-së për përkrahjen e agjendës së gjelbër**

#### **IPA III dhe priorizimi i agjendës së gjelbër**

Bashkimi Evropian e mbështet zbatimin e Agjendës së Gjelbër përmes disa instrumenteve financiare sikurse është Instrumenti ose Asistenca e Para-Anëtarësimit (IPA). Ky mekanizëm

---

<sup>21</sup> Neni 115; *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit*; E qasshme në [https://www.mci-ks.net/repository/docs/20170425093025\\_msa\\_shq.pdf](https://www.mci-ks.net/repository/docs/20170425093025_msa_shq.pdf); Qasur për herë të fundit më: 04.05.2021

mbështetës asiston shtetet potenciale dhe ato kandidatë drejtë integrimit në BE, duke ju ndihmuar në adoptimin dhe zbatimin e reformave thelbësore politike, ekonomike, sociale etj. Fondet IPA ndërtojnë kapacitetet administrative si dhe mbështesin financiarisht vendet që aspirojnë integrimin evropian. Përveç që ndihmojnë vendet në zhvillim, fondet IPA ndihmojnë Bashkim Evropian në përmbushjen e synimeve të vendosura drejtë zhvillimit të qëndrueshëm<sup>22</sup>. Mjetet financuese të fondeve IPA II, të dedikuara për periudhën 2014-2020 janë 11.7 miliardë euro, ndërsa për kornizën e re mbështetëse IPA III që përfshin periudhën 2021- 2027 janë propozuar të dedikohen 14.5 miliardë euro<sup>23</sup>. Duke qenë se kjo kornizë mbështetëse mbulon disa fusha specifike ose programe politike, vendet përfituese duhet të aplikojnë për mbështetje nga këto fonde duke specifikuar një fushë të caktuar. Programet politike që mbulon IPA janë: Reformimi në administrata publike, sundimi i ligjit, ekonomia e qëndrueshme, njerëzit, agrikultura dhe zhvillimi rural. Sipas rregullave specifike të këtij instrumenti mbështetës, një vend përfitues i fondeve IPA lidh Marrëveshje me Komisionin Evropian dhe bashkëpunon ngushtë me të në sektorin i cili vendoset të mbulohet. Duke pasur parasysh nevojën urgjente të Kosovës për intervenim në çështjet mjedisore, në mënyrë që t'i përafrohet standardeve evropiane dhe integrimit në Bashkim Evropian, institucionet e Republikës së Kosovës do të duhej të prioritzonin kriteret dhe çështjet që lidhen me zbatimin e Agjendës së Gjelbër, në projektet pasardhëse për përfitim të fondeve të IPA-së. Përtej fondeve të dalura nga nënshkrimi i Deklaratës së Sofjes, fondet e përfituara në kuadër të kornizës mbështetëse të IPA-së që lidhen me zbatimin e Agjendës së Gjelbër, do të mundësonin Kosovës shanse reale për një të ardhme më të qëndrueshme.

Rruga drejt zbatimit të Agjendës së Gjelbër kërkon përkushtim dhe koordinim të të gjithë akterëve relevantë. Zbatimi i kësaj Agjende duhet të trajtohet me prioritet të lartë nga institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo sepse plotësimi i kriterëve të përcaktuara sipas Deklaratës së Sofjes dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është proces vendimmarrës për zbatimin e Agjendës së Gjelbër, dhe integrimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian. Përforsimi i sundimit të ligjit, harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian, krijimi i strategjive dhe zbatimi i tyre drejtë dekarbonizimit, ruajtjes së mjedisit e tranzicionit në energji të pastër mundëson përfitime të mëdha ekonomike dhe sociale dhe përmirëson cilësinë e jetës së qytetarit kosovar, rrjedhimisht të atij evropian.

Fondet e IPA si instrument për zbatim të Agjendës së Gjelbër.

Bashkimi Evropian luan rol kyç në jetësimin e kësaj Agjende. Përmes mekanizmave mbështetës të lartcekur, BE ka ndarë shuma të caktuara për projekte që kanë për qëllim uljen e karbonizimit, investimet në burime të ripërtërishme, energjinë efiçente, ruajtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit. Iniciativat e Kosovës dhe palëve tjera nënshkruese të Deklaratës së Sofjes, nga Ballkani Perëndimor do të mbështeten nga Plani Ekonomik i Investimeve për Ballkanin Perëndimor nga Komisioni Evropian me një shumë mbështetëse fillestare prej 9 miliardë euro. Edhe bashkëpunimi me organizata të tjera si Traktati i Komunitetit të Energjisë, Programi Rajonal

<sup>22</sup> Instrumenti për Para-Anëtarësim, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian; European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations E qasshme në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/instruments/overview\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/instruments/overview_en); Qasur për herë të fundit më: 09.05.2020.

<sup>23</sup> 2021-2027, *Commission proposal for the Enlargement region, IPA III*; European Commission; E qasshme në <https://seerural.org/wp-content/uploads/2019/04/Annex-15-IPA-III-presentation.pdf>; Qasur për herë të fundit më: 09.05.2020.



për Bashkëpunim, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim etj. mundëson mbështetje të rëndësishme e jetike për zbatimin e Agjendës së Gjellbër në Kosovë.

## **Përfundime**

Deklarata e Samitit të Sofjes në fund të vitit 2020 përbën njërën ndër arritjet më të rëndësishme në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në përpjekjet e vendit për dekarbonizim dhe largim nga varësia nga qymyri. Ishte sinjali i parë i vërtetë për një ndryshim të kursit të të gjithë rajonit dhe në veçanti të Kosovës në planifikimin e politikave në sektorët ekonomik, energjetik dhe të mbrojtjes së mjedisit. Ky zhvillim i rëndësishëm, megjithatë, ende ka mbetur vetëm deklarativ dhe se ende nuk është përkthyer plotësisht në politika të qëndrueshme, priorite strategjike dhe afate ligjërish të obligueshme.

Kosova ende nuk ka miratuar një Strategji të Energjisë që përkthen përkushtimin e marrë përmes Agjendës së Gjellbër për dekarbonizim në kuadrin strategjik të politikave të energjisë. Ky proces, ndonëse ka filluar, është zvarritur pothuaj deri në pjesën e dytë të vitit 2022, ani pse pritej që deri në fund të vitit 2021, të paktën një draft të vihej në diskutim publik. Ndonëse Qeveria ka mbajtur takime paraprake me shoqërinë civile dhe akterët e sektorit të energjisë, procesi si i tillë nuk ka përfshirë anëtar të shoqërisë civile në grupet punuese dhe përgjithësisht diskutimet për skenaret konkrete të Strategjisë kanë mbetur të mbyllura dhe jotransparente.

Kosova ende nuk ka miratuar gjithashtu Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë. Ky dokument kornizë do të mund të shërbente si një ombrellë e politikave të energjisë, mjedisit dhe klimës dhe do të projektonte të ardhmen e të tre fushave në një hark kohor afatgjatë. Megjithëse puna e grupeve punuese ka përfunduar, paqartësitë rreth të ardhmes energjetike, targetet e munguara për ulje të emetimeve dhe baza e munguar në fushën e ndryshimeve klimatike kanë bërë që procesi të stagnoj.

Në pjesën e eficiencës së energjisë, Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, përkundër kapaciteteve të limituara ka arritur të përgatisë rreth shtatëdhjet projekte të cilat priten të fillojnë së zbatuari gjatë vitit 2022. Megjithatë, ende baza ligjore dhe korniza aktuale kufizon Fondin që të mos merret me sektorin rezidencial por vetëm me atë publik. Projektet e sektorit privat që financohen nga EBRD, MCC dhe akterët e tjerë, edhe pse kanë treguar rezultate, janë sfiduar nga ekonomia joformale dhe çmimet e larta të materialeve në mungesë të politikave fiskale të koordinuara të nivelit qendror të qeverisjes. Mungesa e zbatimit të Ligjit për Performancën Energjetike të Ndërtesave gjithashtu është ndër sfidat kyçe të eficiencës. Fuqizimi i zbatimit të ligjit dhe ndryshimi i kornizës ligjore ende nuk kanë ndodhur.

Kosova është vonuar edhe në reformimin e strukturës së mbështetjes për burimet e ripërtrishme të energjisë dhe fuqizimin e sektorit privat për rritje të investimeve dhe diversifikim të burimeve të energjisë. Deri në fund të vitit 2021, Qeveria ka arritur të miratoj vetëm një koncept dokument për burimet e ripërtrishme. Mungesa e një ligji të veçantë, mungesa e një one-stop-shop-i për BRE-të, mos-organizimi i asnjë ankandi për të nxitur konkurrencën dhe incentivuar investimet, struktura e



limituar e mbështetjes për prosumerët dhe mungesa e incentivave fiskale dhe administrative mbesin sfida kryesore.

Në shtyllën e dytë, Kosova ende nuk ka shënuar pothuaj aspak progres. Politikat e prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm si dhe fuqizimi i kalimit nga standardet tek rregulloret e prodhimit dhe trajtimit të mbetjeve mbesin sfida në mënyrë që aktivitetet ekonomike të jenë të qëndrueshme dhe qarkore. Kosova gjithashtu nuk ka paraqitur kritere të qarta para dizajnit të pakove të rimëkëmbjes, ashtu që ato të parashikojnë elementin transformues dhe që të nxisin uljen e ndotjes, ripërdorimin dhe ekonominë qarkore në përgjithësi.

Ndotja mbetet ndër shtyllat më sfiduese të Agjendës së Gjelbër. Kosova ka shënuar pak progres në ndalimin e ndotjes së ajrit, menaxhimit të ujit dhe menaxhimit të tokave. Iniciativa e shoqërisë civile për krijimin e “Koalicionit 27” në fushën e mbrojtjes së mjedisit mbeten hapat e pakët pozitiv në vitin e parë pas nënshkrimit të Deklaratës së Samitit të Sofjes.

Progresi ka munguar edhe në fushën e menaxhimit të ujit dhe tokës me një numër të madh të sipërfaqeve të kontaminuara të tokës dhe me një nivel alarm të humbjeve të ujit të pijes si dhe të kontaminimit të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor. Gjithashtu, ndonëse është rritur buxheti për subvencione në bujqësi, pothuaj asgjë s’është bërë në promovimin e bujqësisë së qëndrueshme, inovacionit, digjitalizimit dhe bashkëpunimit rajonal.

Në fushën e biodiversitetit, ka munguar gjithashtu progresi real. Institucionet nuk kanë bërë sa duhet në fuqizimin e mekanizmave për mbrojtjen e pasurive dhe diversitetit të specieve dhe nuk është bërë sa duhet për përkrahjen e hulumtimit shkencor në këtë fushë.

Kosova ka mundësinë reale të përfitoj nga fondet e BE-së për zbatimin e Agjendës së Gjelbër. Instrumentet financiare për mbështetjen në realizimin e kërkesave nga Agjenda e Gjelbër kanë mundësinë reale të jenë kyçe për zbatimin e objektivave të saj dhe për asistencën e vendit në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Disa hapa janë bërë në drejtim të fuqizimit të rinjëve në administratën publike në mënyrë që përfitimi nga programet e asistencës dhe instrumentet e BE-së të jetë sa më i madh.

## Rekomandime

Qeveria e Kosovës duhet të përshpejtojë hapat për zbatimin e Deklaratës së Samitit të Sofjes përfshirë të përkthej në kuadrin e politikave publike, përkushtimin për dekarbonizim të plotë deri në vitin 2050 dhe për një tranzicion të drejtë të energjisë. Nevojitet një transformim i koordinimit në mes të institucioneve në mënyrë që përpjekjet për zbatimin e plotë të Agjendës së Gjellbër të jenë të koordinuara, eficiente dhe efektive.

### Shtylla 1 - Klima, energjia dhe mobiliteti

#### Rekomandimet kryesore për Shtyllën 1

1. Qeveria të miratoj gjatë vitit 2022 pakon e gjellbër të legjislacionit për energji përfshirë Ligjin për Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, Strategjinë e Energjisë, Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë, Strategjinë e Dekarbonizimit si dhe Planet Komonale për Energji dhe Klimë. Këto dokumente nuk mund të shtyhen për më tutje.
2. Qeveria, në koordinim me Zyrën e Rregullatorit për Energji të organizoj me prioritet së paku 4 ankande në fushën e burimeve të ripërtrishme të energjisë gjatë vitit 2022. Krahas kësaj, të përmbyllet gjatë pjesës së parë të vitit 2022, miratimi i Ligjit për Burime të Ripërtrishme të Energjisë.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji të reformoj Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtrishme të Energjisë. Ndryshimet duhet të startojnë me Kapitullin V të kësaj rregulloreje në atë mënyrë që prosumerëve t'u hiqet apo rritet kapaciteti i lejuar i instalimit dhe i njëjti të ndërlihet me mesataren e konsumit të tyre dhe jo me kërkesat e pa numërta e shpesh të pa arsyeshme të operatorit të distribucionit.
4. Qeveria të miratoj me prioritet Ligjin për Ndryshimet Klimatike dhe të ndërtoj bazat për zbatim të përkushtimit, matje të progresit dekarbonizim të qëndrueshëm.
5. Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe atë të Mjedisit dhe Infrastrukturës të fillojnë diskutimet për gjetjen e modaliteteve për vendosjen e një sistemi të brendshëm të taksimit të karbonit, në atë mënyrë që të zbatohen përkushtimet brenda Shtyllës 1 të Agjendës.
6. Qeveria të intensifikoj përpjekjet për bashkëpunim rajonal në fushën e infrastrukturës. Një Plan Kombëtar për digjitalizimin e shërbimeve të transportit publik dhe për dinamizimin e hartave të aksidenteve, gjendjes së rrugëve etj., do të ishte hap shumë i rëndësishëm për zbatimin e indikatorëve 15-22 të Shtyllës 1.

### Shtylla 2 – Ekonomia qarkore

#### Rekomandimet kryesore për Shtyllën 2

1. Kosova të prioritzoj ekonominë qarkore në Strategjinë e ardhshme kombëtare të zhvillimit ekonomik. Kjo strategji, duhet të parashikoj hapa konkret për promovimin e zhvillimit të

qëndrueshëm me ekonominë qarkore në qendër dhe që bazohet në menaxhim të mençur e digjital.

2. Agjencia e Standardizimit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të ndërtoj një katalog të veçantë të standardeve për ekonominë qarkore me theks të veçantë për prodhimin e qëndrueshëm.
3. Kuvendi i Kosovës përkatësisht Komisioni parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të bëjë monitorimin e detajuar të zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit në mënyrë që të shihet se si mund të fuqizohen dispozitat ligjore për promovim të prodhimit të qëndrueshëm.
4. Ministria e Mjedisit të filloj procedurat për hartimin e Ligjit për Mbetje Industriale. Ky ligj do të përcaktonte prioritetin e zvogëlimit të ndotjeve dhe do të përcaktonte kuotat për zvogëlim të mbeturinave për industri të caktuara bashkë me pako të incentivave fiskale.

### **Shtylla 3 – Ndalimi i ndotjes**

#### **Rekomandimet kryesore për Shtyllën 3**

1. Qeveria të hartoj Ligjin e ri për Mbrojtjen e Natyrës apo të bëjë amendamentimin e Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës në mënyrë që të integroj plotësisht parimin “ndotësi paguan” në legjislacion. Ky parim duhet të jetë baza edhe për vendosjen e sistemit të taksimit të karbonit por edhe për mbledhjen e të hyrave të dedikuara nga industria dhe ndotës të tjerë që shkaktojnë kosto me ndotjen e tyre.
2. Në pajtim me kërkesën 2 të Shtyllës 3 të Agjendës, të miratohet Strategjia e re për Cilësinë e Ajrit. Paraprakisht, gjatë vitit 2022, Qeveria të publikoj një raport të zbatimit të Strategjisë së Cilësisë së Ajrit 2013-2022 bashkë me planin e veprimtimit ku do të identifikohen të gjitha mangësitë, problemet dhe mësimet për Strategjinë e Re. Strategjia e re për cilësinë e ajrit të prioritetizoj shfrytëzimin e teknologjisë informative, të promovoj hulumtimin dhe zhvillimin dhe inovacionin në fushën e mbrojtjes së cilësisë së ajrit.
3. Kosova të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjetet në mënyrë që të fuqizohen standardet e kontrollit teknik të automjeteve.
4. Qeveria të miratoj një Strategji për transformimin e flotës së veturave nga veturat konvencionale në ato elektrike. Kjo Strategji duhet të përfshij politika të incentivimit të përdorimit të automjeteve hibride dhe elektrike, përkrahjen në investime në mbushës elektrik etj.
5. Kosova të vendosë targete për nivelin me përqindje të trajtimit të ujërave të zeza dhe të hartoj plane tre vjeçare për reduktimin e sasisë së ujërave të zeza të patrajuara me qëllim të mbrojtjes së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor nga ndotja dhe kontaminimi.

### **Shtylla 4 dhe Shtylla 5 - Bujqësi dhe prodhim ushqimor i qëndrueshëm dhe Biodiversiteti**

#### **Rekomandimet kryesore për Shtyllat 4 dhe 5**

1. Qeveria të hartoj Kriteret për Bujqësi të Qëndrueshme me rastin e subvencionimit të kulturave bujqësore. Në këtë mënyrë, aktiviteti bujqësor që nxitet nga subvencionimi, të ketë sa më pak kosto të mjedisit dhe sa më pak emetime të dioksidit të karbonit, metanit etj. Ky prioritizim i bujqësisë së qëndrueshme, reduktimit të ndotjeve bujqësore dhe depyllëzimit duhet të jetë në qendër të politikës kombëtare të bujqësisë.
2. Të bëhet rivlerësimi i Librit të Kuq të Faunës dhe Florës në Kosovë me theks të veçantë në vlerësimin e llojeve të rrezikuara dhe masave mbrojtëse që nevojiten.
3. Të krijohet program i veçantë kompetitiv i hulumtimit dhe zhvillimit në kuadër të Ministrisë së Arsimit me qëllim të avancimit shkencor në fushën e biodiversitetit me theks të veçantë në fushat si
4. Qeveria të themeloj një grup të veçantë ndër-sektorial dhe me pjesëmarrje të shoqërisë civile për përcjelljen në zbatimin e Agjendës së Gjellbër. Krahas kësaj, prioritet duhet t'i ipet bashkëpunimit me RCC-në dhe krijimit të mekanizmave institucional përmes krijimit të Departamentit për Agjendën e Gjellbër në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.



---

[www.indep.info](http://www.indep.info)

---